

KLSH pret në takim Presidentin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit në Rumani, z.Florin Ionel Moise

21.09.2023

Kontrolli i Lartë i Shtetit priti në një takim në mjediset e KLSH-së në datën 21.09.2023, Presidentin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit në Rumani, z.Florin Ionel Moise, një institucion homolog me ILDKPKI në Shqipëri.

Delegacioni rumun i Agjencisë Kombëtare të Integritetit (*National Integrity Agency- ANI*) në Rumani, i cili shoqërohej edhe nga përfaqësues të ILDKPKI-së, u prit nga Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Valbona Gaxha dhe disa drejtues të departamenteve e drejtorive.

Znj. Gaxha, falënderoi pjesëmarrësit në takim edhe në emër të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu, duke theksuar se bashkëpunimi me institucionet e pavarura për parandalimin e korrupsionit si dhe shkëmbimi i eksperiencave vlerësohet me rëndësi nga KLSH.

“Ne si institucione të pavarura, identifikohemi si institucione që kontribuojnë drejtpërsëdrejti në parandalimin e korrupsionit, në rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike, të forcimit të shtetit ligjor në tërësi. Kjo mbetet edhe një nga detyrat edhe të detyrimeve që ne kemi në kuadër të anëtarësisë për integrimin europian dhe për më tepër kjo e bën të domosdoshme shkëmbimin e eksperiencave, që për Kontrollin e Lartë të Shtetit është një nga parimet apo mjetet strategjike, jo vetëm në kuadër të zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit, por edhe si pjesë e vizionit të institucionit”, u shpreh znj. Valbona Gaxha.



Z. Florin Ionel Moise bëri një prezantim të rolit të Agjencisë Kombëtare të Integritetit në Rumani, një institucion i pavarur, i cili është krijuar në vitin 2007 për trajtimin e rasteve të korrupsionit, deklarimit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe parandalimit të konfliktit të interesave.

Gjatë takimit me Presidentin e Agjencisë Kombëtare të Integritetit në Rumani, drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, z. Gjovalin Preçi, foli mbi veprimtarinë e KLSH-së, jo vetëm në kontributin që jep institucioni në kuadër të luftës kundër korrupsionit, por edhe mbi impaktin e punës audituese me qëllim mirëqeverisjen dhe mirëadministrimin e fondeve publike.

Përfaqësuesja e ILDKPKI-së, znj. Dorina Laçi, duke falenderuar Kontrollin e Lartë e Shtetit për mikpritjen, tha se takimi është një vlerë e shtuar për partnerët me të cilët po bashkëpunojnë prej 1 viti.